

NJOFTIM

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, bazuar në Urdhërin Nr. 69, datë 13.11.2020 të Rektorit, *shpall* njoftimin për konkurim të hapur, për vendet e lirë të punës në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë:

2 (DY) PERSONEL AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME I KATEGORISË ASISTENT LEKTORË NË FUSHËN E PSIKOLOGJISË/PEDAGOGJISË

Përshkrimi i vendit të punës

- Pedagog me angazhim me kohë të pjesshme
- Mësimdhënie në programin e studimit Bachelor, 1 (një) në fushën e Psikologjisë dhe një në fushën e Pedagogjisë.
- Mbështetje për nevojat e Departamentit dhe Fakultetit.

Kritere të përgjithshme që duhet të plotësoj/në kandidati/ët

- Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkuron;
- Të jetë i aftë të garantoj standartin e cilësisë dhe efikasitetin në mësimdhënie.
- Të ketë aftësinë e punës në grup dhe të komunikimit profesional me kolegët dhe studentët;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës për kryerjen e një vepre penale si dhe të mos jetë person nën hetim;
- Kandidati nuk duhet të ketë patur background negativ në eksperiencat e mëparshme në punë;
- Të mos jetë marrë ndaj tij masë disiplinore “largim nga puna” si dhe të mos jetë në proces gjyqësor me Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë;
- Të mos ketë vepruar ose propaganduar në drejtim të prishjes së imazhit të universitetit dhe autoriteteve drejtuese të UV-së, në median vizive dhe/apo të shkruar, rrjetet sociale etj.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
- Të ketë eksperiencë në punë.

Kritere të veçanta

Kriteret bazë (skualifikuese për personelin akademik me kohë të pjesëshme):

1. Të mbajë të paktën gradën shkencore “Master i Shkencave” në fushën e Psikologjisë dhe Pedagogjisë. Mesatarja e kërkuar të paktën 8 (tetë) për studimet Bachelor dhe Master i Shkencave.
2. Të ketë së paku 5-vite eksperiencë pune me kohë të plotë ose të pjesshme. Përbënë avantazh angazhimi në mësimdhënie me kohë të plotë.

Pikëzimi i kriterëve:

Nr.	Emërtimi	Kriteret e vlerësimit
1.	Grada “Doktor i Shkencave”	40 pikë
2.	Msc	20 pikë
3.	Përvojë në mësimdhënie universitare/në profesion	2 (dy) pikë për çdo vit pune (jo më shumë se 10 pikë)
4.	Botime shkencore dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore	2 (dy) pikë për çdo botim ose pjesëmarrje në konferencë ndërkombëtare dhe 1 (një) pikë për çdo botim ose pjesëmarrje në konferencë kombëtare (jo më shumë se 10 pikë). Kanë përparësi botimet ku kandidati rezulton autor i parë.
5.	Njohje e gjuhës së huaj e certifikuar (ose një cikël studimesh universitare i kryer në gjuhë të huaj në një nga vendet e BE-së apo OECD)	2 pikë
6	Intervista	10 pikë

Dokumentacioni i kërkuar

- Formulari i aplikimit i plotësuar nga aplikanti. Gjetet në adresën www.univlora.edu.al
- Jetëshkrim/ CV;
- Diploma/t universitare (kopje e noterizuar);
- Lista e notave e studimeve universitare (origjinal ose kopje e noterizuar);
- Tituj akademik ose grada shkencore (kopje e noterizuar);
- Dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve, arsimim shtesë, apo të tjera të përmendura në jetëshkrim (kopje të noterizuara);
- Artikuj të botuar, projekte shkencore, etj;
- Dëshmi të pjesëmarrjes në konferenca, seminare, *workshop-e*, etj (kopje të noterizuara);
- Libreza e punës (origjinale ose kopje të noterizuar)
- Raport mjekësor për aftësinë në punë, lëshuar 3 muajt e fundit (origjinal);
- Vërtetimi i gjendjes gjyqësore (dokument origjinal i lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor);
- Fotokopje të kartës së identitetit ID;

Shënim:

Diplomat, çertifikatat, gradat dhe titujt e fituar në institucione të huaja arsimore, të shoqërohen me çertifikatën e njehsimit, bazuar në nenin 92 të Ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërëqimin shkencor në institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

Mënyra e aplikimit

Dokumentat duhet të dorëzohen **vetëm nëpërmjet shërbimit postar** në adresën:



- **Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë,
Lagjja. "Pavarësia", Rr. "Kosova" 9400
Vlorë, Shqipëri.**
- **Drejtoria e Komunikimit dhe e Burimeve
Njerëzore.**
- **Personel akademik me kohë të pjesshme
pranë Departamentit të Edukimit në
Fakultetin e Shkencave Humane**

Afati për aplikim

- ✓ Afati për të aplikuar është 2 dy (javë) kalendarike. Ky afat fillon nga data e nesërme e publikimit të njoftimit në web-site zyrtar të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë: www.univlora.edu.al. (njoftimi u publikua në datën 16.11.2020 dhe afati përfundon në datën 01.12.2020.
- ✓ Dokumentacioni i dorëzuar në shërbimin postar pas datës 01.12.2020, do t'i kthehet aplikantit pa veprime.

Procedura e punësimit të personelit akademik

- ✓ Punësimi i personelit akademik në UV bëhet me konkurs.
- ✓ Konkurimi do të kryhet në dy faza: vlerësimi i dosjes dhe intervista e drejtëpërdrejtë e kandidatit.
- ✓ Dokumentacioni i dorëzuar nga aplikanti në kundërshtim me kërkesat e shpallura, nuk do të merret në konsideratë nga Komisioni *ad hoc*. Vlerësimi do të kryhet vetëm mbi bazën e dokumentacionit të konsideruar të vlefshëm.
- ✓ Komisioni *ad hoc* njofton kandidatët për rezultatet e vlerësimit të fazës së parë.
- ✓ Ankesat në lidhje me vlerësimin e kandidatëve dhe zbatimin e procedurave nga komisioni *ad hoc*, paraqiten te Rektori brenda 5 (pesë) ditëve.
- ✓ Kandidatit i lind e drejta e ankimit nga e nesërmja e njoftimit të vendimit për fazën e parë të vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar. Në këtë rast, Rektori urdhëron komisionin *ad-hoc* për pezullimin e procedurës së konkurimit deri në

përfundimin e procedurës së shqyrtimit të ankimit. Kur vlerëson se ankimi është i pranueshëm, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të ankimit, Rektori vendos me një akt të ri anulimin, shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit të komisionit *ad-hoc*. Vendimi i rektorit i njoftohet komisionit *ad-hoc* i cili në vijim cakton datën dhe njofton kandidatët fitues për zhvillimin e intervistës me gojë.

- ✓ Kandidati i cili kalon fazën e parë të kualifikimit të dosjes, por nuk paraqitet në fazën e dytë të intervistës me gojë, skualifikohet nga konkurimi.
- ✓ Komisioni *ad hoc* vlerëson dhe rendit kandidatët konkurrues sipas pikëzimit të vendosur në rregulloren e UV-së dhe ia përcjell Rektorit i cili vendos në mënyrë përfundimtare mbi secilën kandidaturë.
- ✓ Kundër vendimit të fazës së dytë për vlerësimin e intervistës, kandidati ka të drejtën e ankimit brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi. Në këtë rast, Rektori urdhëron shqyrtimin e ankimit. Kur vlerëson se ankimi është i pranueshëm, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të ankimit, rektori vendos me një akt të ri anulimin, shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit të komisionit *ad-hoc*.
- ✓ Vendimi përfundimtar i Rektorit për miratimin e klasifikimit përfundimtar dhe shpalljen e fituesit, i njoftohet palëve të interesuara.
- ✓ Rektori emëron kandidatin fitues dhe nënshkruan kontratën e punës.

DREJTOR

Eloina TOZAJ